



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL  
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 07.04.2023

## NJOFTIM PUNËSIMI

Në zbatim të Vendimit nr. 877, datë 14.12.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 719, datë 31.10.2014 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, si dhe në VKM nr. 56, datë 01.02.2023 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2023, në njësitë e qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall njoftimin e punësimit për vendet e pa plotësuara si mëposhtë vijon :

### I. DREJTORIA E PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE

#### ➤ SEKTORI I PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE IPARD, MASA 1 DHE MASA 11

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b.

#### ➤ Detyrat kryesore:

1. Analizon, nga ana administrative dosjet e aplikantëve për të aprovuar ose jo aplikimet për Masën 1, 11 si dhe programeve të tjerë me financim të huaj, duke zbatuar legjislacionin përkatës, Manualin e Procedurave dhe Udhëzimet përkatëse;
2. Identifikon në mënyrë të vazhdueshme kërkesat/ankesat e deleguara nga eprori lidhur me aplikantët që kanë aplikuar në Masën 1, 11 si dhe programeve të tjerë me financim të huaj;
3. Asiston në përgatitjen, përditësimin e dokumentacionit për akreditim, trajnime dhe konsultime mbi përafrimin me standartet europiane në menaxhimin e fondeve;
4. Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga eprori përkatës.

#### ➤ Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:

1. Diplomë e nivelit Master Profesional, në Shkenca Ekonomike, Shkenca Bujqësore, Shkenca Natyrore, Shkenca Juridike dhe Shkenca Inxhinierike. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të njehsohen nga institucionet përgjegjëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit

4. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.
5. Preferohet të kenë përvojë pune ose internshipi/praktika profesionale.

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 37, datë 09.04.2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 30, datë 17.03.2016, "Për ratifikimin e marrëveshjes sektoriale ndërmjet Republikës Së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të Be-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit, në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD)";
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".

## **II. DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

➤ **OPERATORE**

SPECIALIST (me kontratë pune të përkohshme 6h/ditë), kategoria IV-b

➤ **Detyrat kryesore:**

1. Ofron shërbim në recepsion dhe/ose në media sociale, numrin jeshil duke respektuar rregullat e etikës dhe komunikimit me qytetarët / fermerët.
2. Informon dhe promovon programet e skemave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

➤ **Kandidatët e interesuar duhet të përmbushin këto kritere:**

1. Diplomë e Nivelit Bachelor në Arsimin e Lartë. Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga institucioni përgjegjës për njehësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të kenë aftësi shumë të mira komunikuese.
3. Të kenë njohuri bazë në përdorimin e kompjuterit
4. Të kenë njohuri bazë mbi zhvillimin bujqësor dhe rural në Shqipëri dhe mbi politikën e përbashkët për bujqësinë me BE-në.
5. Të kenë përvojë pune ose internshipi/ praktika profesionale

➤ **Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Njohuritë mbi VKM nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar.

**Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë brenda datës 11.04.2023, ora 16.30 në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Adresa: Rruga “Muhamet Gjollështa”, Nr. 56, Tiranë): Kërkesën për punësim ku duhet të përcaktojnë pozicionin për të cilin po aplikojnë; një kopje të CV të përditësuar; diplomën e noterizuar; certifikata dhe kualifikime të ndryshme; një fotokopje e librezës së punës; një kopje të ID-së; formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore të firmosur nga aplikuesi; raportin mjeko-ligjor.**

---

**TË GJITHË KANDIDATËT QË APLIKOJNË PËR POZICIONET E MËSIPËRME, DO TË MARRIN INFORMACION VETËM NË FAQEN E INTERNETIT TË AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), PËR FAZAT E MËTEJSHME TË KËSAJ PROCEDURE:**

- për rezultatet e verifikimit
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi (testim me shkrim/ intervista me gojë)
- shpalljen e listës së fituesve

**Për të marrë këto informacione, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e internetit të AZHBR [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al).**

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**